



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punjenoh/Prodato Received/Delivered	29.12.2023	3	viti god year
Organ /Nisma Organ /Institucija Org /Instit	Nr. Post Dok. / Prot. No.	Titulli Emri i Kopulidra	Sasia Koliciteti Quantity
SKOMSTFK	7723/2023		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1524/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ardita Percuku Shyti, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës numër A.nr.1524/2023, të datës 14.12.2023, të parashtruar nga ankuesi

nga Podujeva, kundër organit të punësimit: Komuna e Podujevës, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.12.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

**Hedhet poshtë si e parakohshme** ankesa me numër A.nr.1524/2023, e datës 14.12.2023, e parashtruar nga ankuesi.

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil (tutje vetëm ankuesi), i punësuar në Komunën e Podujevës, më datë 14.12.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se kategorizimi i tij në klasën Profesional 2 me koeficiente 5 të pagës, nuk është i drejtë, dhe së i njëjti duhet të kategorizohet sipas shtojcës nr.10.7 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.12.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Podujevës, ndërsa kjo e fundit, më datë 29.12.2023, ka përcjellë shkresat ndërlidhur me çështjen në shqyrtim dhe vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit është e parakohshme, sepse:

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi është i punësuar në Komunën e Podujevës dhe se i njëjti sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.13-101/03-0097404/22 të datës 23.11.2022, ushtron pozitën e punës *Zyrtar për Regjistrim të Adresave*, në Drejtorinë për Planifikim Hapësinor dhe Rregullativ.

Më tej, nga shkresat e lëndës, rezulton se ankuesi ka realizuar koeficient shtatë (7) të pagës-sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa, në muajin shkurt 2023, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesja është klasifikuar në klasën "Profesional 2", me koeficient të pagës Gj 35-5/525.00/1.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se është i pakënaqur me koeficientin e kategorizimit sipas klasës Profesional 2 me arsyetimin se akt emërimi nuk korrespondon me konkursin në të cilin është pranuar si Specialistë i Hartografisë dhe i njëjti kërkon që të kategorizohet në grupin Gj11-Specialist sipas shtojcës numër 10.7 të me koeficient të pagës 6.56, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik .

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj''*, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Podujevës ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficientëve, të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr. 04/128, të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Vendimit Nr.17/162 të datës 27.09.2023, institucionet e administratës publike janë të obliguara që ta përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit, për kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë e grupit të Specialistëve sipas koeficientit 6.56 është e parakohshme, dhe si e tillë, në këtë fazë, nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore. Rrjedhimisht, e njëjta, është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tij të punës.


Kështu që, mbështetur në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7, i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1524/2023

Ardita Percuku-SHYTI



Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI



Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit.
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

